



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.830/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Shkëlzen Feka, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. Pranohet** si i bazuar apeli i parashtruar nga Shkëlzen Feka, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri Shkëlzen Feka, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për vendvotimet: 2701B/09R dhe 2709B/02R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 10.11.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.830/2017, të parashtruar nga Shkëlzen Feka, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, me të cilën kërkon që të verifikohen votat e tij në vendvotimet 2701B/09R dhe 2709B/02R, pasi që konsideron që ju është bërë e padrejtë sepse sipas parashtruesit të ankesës numri i votave të tij në KVV dhe ato të rinumëruara në QNR është i njëjtë, mirëpo ato nuk figurojnë në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

**Apeli është i bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga ankuesi, ka mospërputhje të votave në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe Rezultatin Përfundimtar të shpallur nga KQZ, për kandidatin Shkëlzen Feka. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri Shkëlzen Feka, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.A.nr.830/2017 me datën 12.11.2017



**Kryesues i Panelit**  
**Gyltëne Sylejmani**

***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.